



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1518/9 prot

Datë 01.11.2021

V E N D I M

K.P.P. 827/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.11.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Liqeni VII” SHA në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-99369-06-28-2021, me objekt: “*Ndërtim Rruga Demokracia Loti III, Bathore*”, me fond limit 147,987,273 (njëqind e dyzet e shtatë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Klajger Konstruksion” SHPK.

Ankimues:

BOE “Liqeni VII” SHA & “Al-Asfalt” SHPK & “S.M.O. Union” SHPK
Rruga “Dituria”, Zona Kadastrale nr. 8516, Nr. Pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi postar 2007, Shkozet, Durrës

Autoriteti Kontraktor:	Bashkia Kamëz “Bulevardi Blu” nr.492 Kamëz, Tiranë
Subjekti i Interesuar:	BOE “Klajger Konstruksion” SHPK & “Varaku-E” SHPK & “Rafaelo 2002” SHPK Bathore 6, Kamëz (Pranë Kopshtit të fëmijeve Bathore 6), Bathore.
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.06.2021, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-99369-06-28-2021, me objekt: “*Ndërtim Rruga Demokracia Loti III, Bathore*”, me fond limit 147,987,273 (njëqind e dyzet e shtatë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 22.07.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 09.08.2021, ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përkatësisht:

BOE “Liqeni VII” SHA & “Al-Asfalt” SHPK & “S.M.O. Union” SHPK	117,745,409.25 lekë	skualifikuar
BOE “Klajger Konstruksion” SHPK & “Varaku-E” SHPK & “Rafaelo 2002” SHPK	117,854,555 lekë	kualifikuar
BOE “Biba X” SHPK & “Aurora konstruksion” SHPK	119,799,245 lekë	kualifikuar
BOE “Shëndelli” SHPK & “B 93 II” SHPK	119,973,709 lekë	kualifikuar
BOE “Kacdedja” SHPK & “Vashtemia” SHPK “Everest” SHPK	125,315,030 lekë 147,793,506 lekë	kualifikuar skualifikuar

II.4. Në datën 09.08.2021 operatori ekonomik “Liqeni VII” SHA është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, sipas argumentimi/arsyetimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, si më poshtë vijon:

1.Operatori ekonomik “LIQENI VII” i cili ka aplikuar në tenderin me objekt: “Ndërtimi i Rrugës Demokracia Loti III Bathore”, njëkohësisht me Bashkinë Kamëz ka të lidhur dy kontrata me objekt:

1.Ndërtim i rrjetit të ujësjellësit në zonën Fushë Kamez.

2. Rikonstruksion i kopshtit Ahmet Zogu.

Në deklaratën përmbledhëse operatori ekonomik “LIQENI VII” deklaroi se makineritë që ka deklaruar në këtë procedurë nuk i ka të angazhuara në asnjë procedurë tjetër, dhe se vërtetimi i të kundërtës përbën shkak për skualifikim.

Komisioni i Vleresimit të Ofertave, konstaton se disa nga makineritë e deklaruara në këtë procedurë i ka njëkohësisht të angazhuara edhe në kontrata tjera me Bashkinë Kamëz. Makineritë janë si më poshtë vijon:

- 1. Automjeti me targë, AA583FH njëkohësisht i deklaruar dhe angazhuar edhe në kontratën ndërtimi rrjetit ujësjellës, Fushë Kamëz.*
- 2. Automjeti me targë DR 7366C i angazhuar njëkohësisht edhe në kontratën me objekt ndërtim i rrjetit ujësjellës, Fushë Kamëz.*
- 3. Automjeti me targë AA829SR i angazhuar njëkohësisht edhe në kontratën me objekt Ndërtimi rrjetit ujësjellës, Fushë Kamëz.*
- 4. Automjeti me targë KR 7934A i angazhuar njëkohësisht edhe në kontratën me objekt Rikonstruksion i kopshtit “Ahmet Zogu”.*
- 5. Automjeti me targë DR7366C i angazhuar njëkohësisht edhe në kontratën me objekt Rikonstruksion i kopshtit “Ahmet Zogu”.*

*2.Operatori ekonomik “Liqeni VII” ka në mungesë dhe makineritë e mëposhtme:
Mungon Kulla e ndriçimit e kërkuar në dokumentet Standarde të tenderit.
Mungon Makineria e quajtur Frezë me gjerësi 60 cm.*

3.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori “LIQENI VII” edhe stafin teknik që ka deklaruar tek kjo procedurë, e ka të angazhuar edhe tek kontrata që ka me Bashkinë Kamëz, me objekt ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit “Fushë Kamëz.” Konkretisht/ Inxh. Bujar Gishti, Inxh. Hamit Skana, dhe Inxh. Elmira Makishti.

II.5. Në datën 11.08.2021 është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 122, më datë 16.08.2021.

II.6. Nga verifikimet e kryera, konstatohet se në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 122, më datë 16.08.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku rezulton fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë “Klajger Konstruksion” SHPK & “Varaku-E” SHPK & “Rafaelo 2002” SHPK.

II.7. Në datën 17.08.2021, operatori ekonomik ankimues “Liqeni VII” SHA ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, si dhe kundërshtimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Klajger Konstruksion” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të

procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1518/2 prot., datë 18.08.2021 lidhur me lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Liqeni VII” SHA, si dhe kundërshtimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Klajger Konstruksion” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.9. Me shkresën nr. 7987/2 prot., datë 23.08.2021 protokolluar me tonën me nr. 1518/3 prot., datë 26.08.2021, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatorit ekonomik “*Liqeni VII*” SHA për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor, konkretisht Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) me vendim shumice (dy anëtarë), e ka pranuar pjesërisht ankesën.

Në kthim- përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton se këto pika të ankesës janë pranuar si vijon: “*Në sistemin e prokurimit elektronik në dokumentet e tenderit dhe në shtojcën e publikuar “Mbi modifikimin dhe ndryshimin e dokumenteve standarde të tenderit” nuk është vendosur një kriter kualifikues, dhe për sa kohë që ky kriter nuk është i përcaktuar në kriteret kualifikuese, atëherë mbi ofertuesit nuk rëndon detyrimi ligjor për ta përmbushur kërkesën e arsytimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku shprehet se: “Stafi teknik që ka deklaruar te kjo procedurë, e ka të angazhuar edhe tek kontrata që ka me Bashkinë Kamëz, me objekt: “Ndërtim i Rrjetit të Ujësjellësit “Fushë Kamëz”. Për arsyet e mësipërme, pretendimi i ofertuesit “Liqeni VII” SHA pranohet pjesërisht”.*

II.10. Me shkresën nr. 8147 prot., datë 24.08.2021 protokolluar me tonën me nr. 1518/4 prot., datë 26.08.2021, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatorit ekonomik “Liqeni VII” SHA për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor, konkretisht Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) me vendim pakice (një anëtar), e ka pranuar ankesën.

II.11. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin 556/2021, datë 30.08.2021 ka vendosur:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit me “Procedurë e hapur,” me Nr. REF-99369-06-28-2021, me objekt “Ndërtim Rruga Demokracia Loti III, Bathore”, me fond limit 147,987,273 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.*
2. *Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*
3. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.12. Me shkresën nr. 123 prot., datë 10.09.2021 protokolluar me tonën me nr. 1518/6 prot., datë 13.09.2021, operatori ekonomik “Liqeni VII” SHA ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik plotësim dokumentacioni lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur.

II.13. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është paraqitur asnjë argumentet nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.14. Me shkresën nr. 1518/7 prot., datë 06.10.2021 Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Agjencisë së Prokurimit Publik, me anë të së cilës ka kërkuar për sqarim lidhur me “Formularin përmbledhës të vetdeklarimit” sipas dokumenteve standarde të tenderit për punë publike, konkretisht shtojca nr. 8/C/D, sqarim nëse këto dy deklarata kanë të njëjtin qëllim, dhe cila prej tyre prevalon në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

II.15. Me shkresën nr. 6256/1 prot., datë 19.10.2021 protokolluar me tonën me nr. 1518/8 prot., datë 21.10.2021, nga Agjencia e Prokurimit Publik ka dërguar shkresën me lëndë “Kthim-përgjigje” ku ndër të tjera ka sqaruar se “Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim APP)” mori në shqyrtim shkresën tuaj Nr. 1518/7 prot., datë 06.10.2021 me objekt: “Kërkesë për sqarim”. Nga shqyrtimi i shkresës tuaj kuptojmë se, kërkon nga APP sqarim, sa i takon disa parashikimeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e Dokumenteve Standarde të Tenderit (në vijim “DST”) për Punë Publike.

Konkretisht, sipas jush, në shtojcën nr. 8 të DST, Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, citohet që, mjetet e poshtëshënuara, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

Ndërkohë që, në pikën D, të po kësaj shtojce: Deklaratë “Mbi Mosanagazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata të Tjera” citohet që, mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

Sa më sipër, kërkon nga APP sqarim nëse këto dy deklarata kanë të njëjtin qëllim, dhe cila prej tyre prevalon në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Lidhur me sa keni kërkuar në shkresën tuaj se, APP i ushtron kompetencat e saj sipas parashikimeve të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” (në vijim LPP).

Në nenin 23, gërma “ç” të LPP përcaktohet se “Agjencia e Prokurimit Publik për përmbushjen e detyrave të saj jep këshilla dhe asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik”.

Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, nga autoriteti kontraktor ka si synim kryesor që, t’i shërbejë për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojmë se zotërojmë kualifikimet e nevojshme juridike,

financiare dhe aftësitë teknike e profesionale, për të zbatuar kontratën, sipas parashikimeve të nenit 77 të LPP.

Në nenin 39/6/d, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (në vijim VKM), parashikohet që: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

.... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Gjithashtu, në nenin 26, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 2, gërma “i”, të VKM parashikohet se: “.. operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti”.

Pra, kriteri për kualifikim, mbi disponimin e mjeteve dhe pajisjeve duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas Shtojcës 8 të DST.

Qëllimi i paraqitjes së Deklaratës “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” në këtë shtojcë, është listimi, i mjeteve që disponon operatori ekonomik (në pronësi ose me qira) me të gjitha të dhënat e tyre, sikurse janë: lloji i mjetit, targa, shasia, etj.

Ndërkohë që, qëllimi i paraqitjes së Deklaratës “Mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata të Tjera”, po në këtë shtojcë, është garantimi i disponueshmërisë së mjeteve për plotësimin me sukses të kontratës, objekt prokurimi, sipas kërkesave mbi mjetet e kërkuara.

Pra, qëllimi për të cilat kërkohet paraqitja e secilës nga këto deklarata në shtojcën 8 të DST, është i ndryshëm. Në këtë kuptim, duke qenë se, nuk kanë të njëjtin qëllim, atëherë nuk mund të prevalojë asnjëra prej tyre, por secila duhet të interpretohet, sipas qëllimit të saj. Në këtë kuptim, nëse po vlerësohet garantimi i disponueshmërisë së mjeteve, ky vlerësim duhet bërë, duke iu referuar deklaratës “Mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Të Tjera”. Gjithsesi, marrë shkas nga konstatimi juaj, APP do të mbajë në konsideratë rastin në fjalë për saktësime të nevojshme që mund t’i bëhen kësaj shtojce të DST”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Liqeni VII” SHA, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen: “[...] A/4. Pretendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave se: “Operatori ekonomik “Liqeni VII” SHA ka në mungesë dhe makineritë e mëposhtme: Mungon Makineria e quajtur “Frezë me gjerësi 60 cm”, nuk qëndron duke e argumentuar si më poshtë:

Në këtë tender kompania jonë ofertoj me cilësinë e anëtarit të bashkimit të shoqërive “Liqeni VII” SHA & “Al-Asfalt” SHPK & “SMO Union” SHPK.

1)Për sa i përket pajisjes “Kullë ndriçimi” kompania jonë “Liqeni VII” SHA ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Deklarimit se disponon 2 (dy) Kulla ndriçimi, të cilat janë marrë me qira nga kompania jonë me kontratë noteriale të qirasë Nr. 11093 Rep., datë 21.07.2021 dhe me afat deri në përfundimin e objektit.

2)Për sa i përket pajisjes “Frezë me gjerësi 60 cm” anëtari i bashkimit të shoqërive “Liqeni VII” SHA & “Al-Asfalt” SHPK & “SMO Union” SHPK dhe konkretisht kompania “Al-Asfalt” SHPK ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Deklarimit se disponon 1 (një) frezë me gjerësi 60 cm dhe 1 (një) frezë më gjerësi 90 cm, të cilat i disponon përkatësisht me deklaratën doganore R57734, datë 15.08.2013 dhe faturën tatimore të blerjes nr. 141, datë 04.06.2015.

3)Për sa i përket pajisjes “Frezë me gjerësi 60 cm” anëtari i bashkimit të shoqërive “Liqeni VII” SHA & “Al-Asfalt” SHPK & “SMO Union” SHPK dhe konkretisht kompania “SMO Union” SHPK ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Deklarimit se disponon 1 (një) frezë me gjerësi 60 cm, të cilën e disponon me faturën tatimore të blerjes nr. 14, datë 11.06.2014.

Për sa më sipër, pretendimi i KVO-së nuk qëndron, pasi në si bashkim shoqërisht kemi vërtetuar se disponojmë 2 (dy) kulla ndriçimi dhe 2 (dy) freza me gjerësi 60 cm.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.8 tek kapaciteti teknik, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5 deri ne 12 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton)	4 copë	Pronësi ose me qera

<i>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 10 ton)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 0.5 ton deri 5 ton për secilin kamionçinë)</i>	<i>5 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobitumatrice</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Ekskavator me goma</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Ekskavator me zinxhirë</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-hekur nën 6 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-gomë mbi 10 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-hekur deri 8 ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-gomë deri në 6,5 ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompaktor</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fadromë me goma</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Grejder me goma e targuar</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pirun</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Buldozer</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinç</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minieskavator</i>	<i>5 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Frezë me gjerësi 60 cm</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Frezë me gjerësi 90 cm</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fabrikë asfaltbetoni e pajisur me leje III.1.B</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera/Kontrate noteriale furnizimi</i>

<i>Dozator për prodhimin e asfaltobetonit me ngjyrë</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Nyje thyerje materiale inerte</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minifadromë</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator</i>	<i>5 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motosaldatrice</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Elektroorgano</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kulle ndriçimi</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makine për ngjitje tubash HDPE</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makineri prerëse asfalti</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vinç me kosh</i>	<i>2 Copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.(Shtojca 8 /C)

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.*
- d) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

Në shtojcën 1 të datës, 09.07.2021, pika 2.3.8

6. Në pjesën Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik pika 2.3.8

BËHET

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5 deri ne 12 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton)	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 10 ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 0.5 ton deri 5 ton për secilin kamionçinë)	3 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Ekskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Ekskavator me zinxhirë	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadromë me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul hekur-hekur deri 6 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul hekur-hekur deri 8 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul hekur-gomë deri në 6,5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul hekur-gomë mbi 10 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kompaktor	3 copë	Pronësi ose me qera
Grejder me goma e targuar	1 copë	Pronësi ose me qera
Pirun	2 copë	Pronësi ose me qera
Buldozer	1 copë	Pronësi ose me qera

<i>Autovinç</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minieskavator</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Frezë me gjerësi 60 cm</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Frezë me gjerësi 90 cm</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fabrikë asfaltbetoni e pajisur me leje III.1.B</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera/Kontrate noteriale furnizimi</i>
<i>Nyje thyerje materiale inerte</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minifadromë</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator</i>	<i>5 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motosaldatrice</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Elektroorgano</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kullë ndriçimi</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makine për ngjitje tubash HDPE</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makineri prerëse asfalti</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vinç me kosh</i>	<i>1 Copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Liqeni VII” SHA & “Al-Asfalt” SHPK & “S.M.O. Union” SHPK kanë nënshkruar një kontratë bashkëpunimi për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, me datë 19.07.2021, ku sipas së cilës: shoqëria “**Liqeni VII**” SHA merr përsipër të kryejë punimet e ndërtimit në masën **39 %**, konkretisht zërat që do të përshkruhen në mënyrë të detajuar në pasqyrën e ndarjes së punimeve hartuar për këtë qëllim midis shoqërive pjesëmarrëse dhe bashkëngjitur si pjesë e pa ndarë e kësaj marrëveshje.

Shoqëria “**Al-Asfalt**” SHPK merr përsipër të kryejë punimet e ndërtimit në masën **51 %**, konkretisht zërat që do të përshkruhen në mënyrë të detajuar në pasqyrën e ndarjes së punimeve hartuar për këtë qëllim midis shoqërive pjesëmarrëse dhe bashkëngjitur si pjesë e pa ndarë e kësaj marrëveshje.

Shoqëria “S.M.O. Union” SHPK merr përsipër të kryejë punimet e ndërtimit në masën **10 %**, konkretisht zërat që do të përshkruhen në mënyrë të detajuar në pasqyrën e ndarjes së punimeve hartuar për këtë qëllim midis shoqërive pjesëmarrëse dhe bashkëngjitur si pjesë e pa ndarë e kësaj marrëveshje.

- Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Liqeni VII” SHA, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar:

- Formular përmbledhës i vetëdeklarimit (shtojca 8).

- Deklaratë për mjetet e pajisjet teknike datë 22.07.2021.

III.1.3. Në pikën 2, të nenit 14 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës”.*

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të LPP-së përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor*

mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 dhe gërma “i” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti”;*

Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

6. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

d) *mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]*”.

Në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. *Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

2. *Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*

3. *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithëcka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Gjithashtu, në fazën e vlerësimit, autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë parashikimin e nenit 88, pika 3 e VKM, sipas së cilës secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Në rastin konkret, referuar marrëveshjes midis operatorëve ekonomikë, konkretisht për operatorin ekonomik "Liqeni VII" SHA ka marrë përsipër realizimin e punimeve në masën **39 %**, referuar zërat që janë përshkruar në mënyrë të detajuar në pasqyrën e ndarjes së punimeve hartuar për këtë qëllim midis shoqërive pjesëmarrëse dhe bashkëngjitur si pjesë e pa ndarë e kësaj marrëveshje, sipas së cilët operatori ekonomik "Liqeni VII" SHA ka marrë përsipër sipas masës korresponduese në % për çdo zë punimi sipas kapitujve të objekt preventivit bashkëlidhur kësaj marrëveshje midis palëve. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për disponimin e mjeteve Kullë ndriçimi 2 (dy) copë dhe Frezë me gjerësi 60 cm 1 (një) copë, Komisioni Prokurimit Publik konstaton, se sipas parashikimeve të dispozitave të nenit 26, pika 2, gërma "i" të VKM, kriteri për kualifikim mbi disponimin e mjeteve dhe pajisjeve duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të dokumenteve standarde të tenderit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), shoqëria "Liqeni VII" SHA ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në shtojcën nr. 8 /C të dokumenteve të tenderit për mjetet me qira, për rastin në fjalë Kullë ndriçimi, por nuk ka përcaktuar numrin e tyre, ku ka deklaruar kontratën e qirasë nr. 11093 Rep., Nr. 4058 Kol., me afat të kontratës së qerasë (data e fillimit dhe e mbarimit), me datë 21.07.2021 - deri në përfundim të objektit. Ndërkohë, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit shtojca 8/B, ka deklaruar në listën e mjeteve Kullë ndriçimi 2 (dy) copë. Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit por edhe gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk ka pasqyruar asnjë informacion nëse i ka kërkuar apo jo informacion apo sqarim në përputhje me pikën 7, të nenit 26 të VKM sipas së cilës *Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime*

dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, dhe në këto rast autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë sqarim apo argument për arritjen e një përfundimi të saktë që ankimesi nuk disponon mjetin në fjalë.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes për disponimin e mjetit Frezë me gjerësi 60 cm 1 (një) copë, Komisioni Prokurimit Publik konstaton se, në argumentimet që ka dhënë operatori ekonomik ankimes “Liqeni VII” SHA, ka sqaruar se shoqëria “Al-Asfalt” SHPK ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dhe në shtojcën nr. 8 /C të dokumenteve të tenderit për mjetet me qira, ku ka deklaruar mjetin në pronësi për frezë me gjerësi 90 cm, konkretisht dokument doganor nr. R57734 datë 15.08.2013 dhe faturë TVSH nr. 141, datë 04.06.2015. Ndërsa, shoqëria “S.M.O. Union” SHPK ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në shtojcën nr. 8 /C të dokumenteve të tenderit për mjetet me qira, ku ka deklaruar mjetin në pronësi për Frezë asfalti, pa specifikuar nëse është me gjerësi 60 cm apo 90 cm, deklaruar me faturë TVSH. Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit por edhe gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk ka pasqyruar asnjë informacion nëse i ka kërkuar apo jo informacion apo sqarim në përputhje me pikën 7, të nenit 26 të VKM sipas së cilës *Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, dhe në këtë rast autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë sqarim apo argument për arritjen e një përfundimi të saktë që bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk disponon mjetin në fjalë.*

KPP sqaron se, kriteri i kualifikimit mbi disponimin e mejeve dhe pajisjeve duhet të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik sipas shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit. Nga verifikimi i dokumenteve të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), operatori ekonomik ankimes “Liqeni VII” SHA ka vetëdeklaruar se disponon mjetin Kullë ndriçimi 2 (dy) copë, e disponuar nëpërmjet kontratës së qerasë nr. 11093 Rep., Nr. 4058 Kol., me afat të kontratës së qerasë (data e fillimit dhe e mbarimit), me datë 21.07.2021 - deri në përfundim të objektit, duke përmbushur kriterin kualifikues mbi disponimin e mjeteve për këtë fazë, ku autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në rregullat e VKM.

Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse,

Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Liqeni VII” SHA, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen: “[...]Në kriterin kualifikues të pikës 2.3.8 “Kriteret e veçanta për kualifikim” të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit është përcaktuar se:

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5 deri ne 12 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton)</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 10 ton)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 0.5 ton deri 5 ton për secilin kamionçinë)</i>	<i>5 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobitumatriçe</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobetonierë</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Ekskavator me goma</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Ekskavator me zinxhirë</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-hekur nën 6 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-gomë mbi 10 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-hekur deri 8 ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

<i>Rrul hekur-gomë deri në 6,5 ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompaktor</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fadromë me goma</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Grejder me goma e targuar</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pirun</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Buldozer</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinç</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minieskavator</i>	<i>5 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Frezë me gjerësi 60 cm</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Frezë me gjerësi 90 cm</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fabrikë asfaltobetonit e pajisur me leje III.1.B</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera/Kontrate noteriale furnizimi</i>
<i>Dozator për prodhimin e asfaltobetonit me ngjyrë</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Nyje thyerje materiale inerte</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minifadromë</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator</i>	<i>5 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motosaldatriçe</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Elektroorgano</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kullë ndriçimi</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makinë për ngjitje tubash HDPE</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makineri prerëse asfalti</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vinç me kosh</i>	<i>2 Copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. (**Shtojca 8 /C**)

- e) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).
- f) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- g) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.
- h) **Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.**

Ndërkohë në fazën e publikimit të kësaj procedure prokurimi autoriteti kontraktor duke marrë shkas dhe nga problematikat e konstatuara nga APP, në kuadër të monitorimeve të kryera prej saj, lidhur me hartimin e kriterëve të pranimit, vendosi të bëjë modifikimin e tenderit, ku ndër të tjera ka modifikuar si më poshtë:

6. Në pjesën Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik pika 2.3.8

BEHET

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5 deri në 12 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton)	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 10 ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 0.5 ton deri 5 ton për secilin kamionçinë)	3 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	2 copë	Pronësi ose me qera

<i>Autobitumatriçe</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Ekskavator me goma</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Ekskavator me zinxhire</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fadromë me goma</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-hekur deri 6 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-hekur deri 8 ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-gome deri në 6,5 ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-gome mbi 10 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompaktor</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Grejder me goma e targuar</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pirun</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Buldozer</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinç</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minieskavator</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Frezë me gjerësi 60 cm</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Frezë me gjerësi 90 cm</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fabrikë asfaltbetoni e pajisur me leje III.1.B</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera/Kontrate noteriale furnizimi</i>
<i>Nyje thyerje materiale inerte</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minifadromë</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator</i>	<i>5 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

<i>Motosaldatriçe</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Elektroorgano</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kullë ndriçimi</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makinë për ngjitje tubash HDPE</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makineri prerëse asfalti</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vinç me kosh</i>	<i>1 Copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Fillimisht, duam të sqarojmë se njoftimi i skualifikimit nga ana e Komisionit të Vlerësimit të ofrtave nuk na është bërë me dije se cilin kriter kualifikues të përcaktuar në shtojcën 7 të DST nuk kemi plotësuar, çka na detyron që t'iu argumentojmë me rradhë përmbushjen e kriterëve kualifikues që lidhen me mjetet dhe stafin si më poshtë vijon:

A. Argumentet lidhur me përmbushjen e kriterëve kualifikuese lidhur me mjetet.

A/1. Pretendimi i Komisionit të Vlerësimit të ofrtave se: “Në deklaratën përmbledhëse operatori ekonomik “Liqeni VII” SHA deklaroi se makineritë që ka deklaruar në këtë procedurë nuk i ka të angazhuara në asnjë procedurë tjetër, dhe se vërtetimi i të kundërtës përbën shkak për skualifikim”, nuk qëndron, pasi sikurse jua kemi pasqyruar më sipër në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 të shtojcës 7 të DST, i cili është modifikuar dhe që pas modifikimit nuk është përcaktuar që ky kriter përmbushet me deklarinimin e këtyre mjeteve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8/C dhe dorëzimit të këtij formulari në ofertën e kësaj procedure prokurimi. Ndërkohë, nga leximi me kujdes nga ana jonë i kriterëve kualifikuese të përcaktuara në shtojcën 7 të DST konkudojmë se është kërkuar plotësimi dhe dorëzimi i Formulari Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 vetëm për plotësimin e kriterëve kualifikuese si më poshtë:

- Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, të shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të modifikuara.*
- Kriterin kualifikues të pikës 2.3.6 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” tek “Kapaciteti teknik” të shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të modifikuara.*

Prandaj, për sa parashtroam më sipër, kjo arsye skualifikimi nuk qëndron, pasi në kriterin kualifikues të pikës 2.3.8 “kriteret e veçanta të kualifikimit” të “kapacitetit teknik” të shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të modifikuara nuk është përcaktuar që ofertuesit duhet të deklarojnë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8/C mjetet e përcaktuara në pikën 2.3.8 dhe dorëzimin e saj, pra kjo arsye skualifikimi është mbështetur mbi një kriter kualifikues të pa kërkuar në dokumentat e tenderit të modifikuara.

A/2. Pretendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave se: “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, konstaton se disa nga makineritë e deklaruar në këtë procedurë i ka njëkohësisht të angazhuara edhe në kontrata tjera me Bashkinë Kamëz. Makineritë janë si më poshtë vijon:

1. Automjeti me targë, **AA583FH** njëkohësisht i deklaruar dhe angazhuar edhe në kontratën **ndërtimi rrjetit ujësjellës, Fushë Kamëz.**

2. Automjeti me targë **DR 7366C** i angazhuar njëkohësisht edhe në kontratën me objekt **ndërtim i rrjetit ujësjellës, Fushë Kamëz.**

3. Automjeti me targë **AA829SR** i angazhuar njëkohësisht edhe në kontratën me objekt **Ndërtimi rrjetit ujësjellës, Fushë Kamëz.**

4. Automjeti me targë **KR 7934A** i angazhuar njëkohësisht edhe në kontratën me objekt **Rikontruksion i kopshtit “Ahmet Zogu”.**

5. Automjeti me targë **DR7366C** i angazhuar njëkohësisht edhe në kontratën me objekt **Rikontruksion i kopshtit “Ahmet Zogu”,** nuk qëndron, pasi sikurse jua kemi pasqyruar më sipër në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 të shtojcës 7 të DST, i cili është modifikuar dhe që pas modifikimit nuk është përcaktuar që ky kriter do të konsiderohet i përmbushur jo vetëm me deklarin e këtyre mjeteve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8/C dhe dorëzimit të këtij formulari në ofertën e kësaj procedure prokurimi, por edhe me deklarin nga ana e ofertuesit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të faktit se këto mjete të deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe që ky deklarin lidhur me angazhimin do të jetë objekt verifikimi nga ana e KVO dhe se në rast se konstatohej se këto mjete janë të angazhuara në kontrata të tjera atëherë oferta do të skualifikohet.

Ndërkohë, nga leximi me kujdes nga ana jonë e kriterëve kualifikues të përcaktuara në shtojcën 7 të DST konkludojmë se është kërkuar plotësimi dhe dorëzimi i Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 vetëm për plotësimin e kriterëve kualifikues si më poshtë:

➤ Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, të shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të modifikuara.

➤ Kriterin kualifikues të pikës 2.3.6 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” tek “Kapaciteti teknik” të shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të modifikuara.

Prandaj, për sa parashtruar më sipër, kjo arsye skualifikimi nuk qëndron, pasi në kriterin kualifikues të pikës 2.3.8 “kriteret e veçanta të kualifikimit” të “kapacitetit teknik” të shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të modifikuara nuk është përcaktuar që jo vetëm që ofertuesit duhet të deklarojnë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8/C mjetet e përcaktuara në pikën 2.3.8 dhe dorëzimin e saj, por edhe me deklarin nga ana e ofertuesit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të faktit se këto mjete të deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe që ky deklarin lidhur me angazhimin do të jetë objekt verifikimi nga ana e KVO dhe në rast se konstatohej se këto mjete janë të angazhuara në kontrata të tjera atëherë oferta do të skualifikohet, pasi kjo arsye skualifikimi është mbështetur mbi një kriter kualifikues të pa kërkuar në dokumentat e tenderit të modifikuara.

A/3. Pretendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave se: “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, konstaton se disa nga makineritë e deklaruar në këtë procedurë i ka njëkohësisht të angazhuara edhe në kontrata tjera me Bashkinë Kamëz. Makineritë janë si më poshtë vijon:

1. Automjeti me targë, AA583FH njëkohësisht i deklaruar dhe angazhuar edhe në kontratën ndërtimi rrjetit ujësjellës, Fushë Kamëz.

2. Automjeti me targë DR 7366C i angazhuar njëkohësisht edhe në kontratën me objekt ndërtim i rrjetit ujësjellës, Fushë Kamëz.

3. Automjeti me targë AA829SR i angazhuar njëkohësisht edhe në kontratën me objekt Ndërtimi rrjetit ujësjellës, Fushë Kamëz.

4. Automjeti me targë KR 7934A i angazhuar njëkohësisht edhe në kontratën me objekt Rikonstruksion i kopshtit “Ahmet Zogu”.

5. Automjeti me targë DR7366C i angazhuar njëkohësisht edhe në kontratën me objekt Rikonstruksion i kopshtit “Ahmet Zogu”, nuk qëndron duke e argumentuar si më poshtë:

Në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 15, të “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të “Kapaciteti teknik” të shtojcës 12 të DST të procedurës së prokurimit të kontratës së lidhur midis BOE “Liqeni VII” SHA & “Kupa” SHPK dhe Bashkisë Kamëz me objekt: “Ndërtim i rrjetit ujësjellës, Fushë Kamëz” është përcaktuar se:

15. Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr.	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1.	Automjete vetëshkarkues me tonazh mbi 25 ton	Copë	4
2.	Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	Copë	2
3.	Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 10 (dhjete) ton dhe maksimumi 15 (pesëmbëdhjetë) ton	Copë	2
4.	Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	Copë	2
5.	Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(një pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	Copë	2
6.	Automjet me kosh për punime në lartësi	Copë	1
7.	Betoniere	Copë	3
8.	Depozita uji	Copë	3
9.	Autvinç 7-10 ton	Copë	1
10	Gjenerator jo më pak se 200 kva	Copë	1

11	<i>Rrul gome – hekur (kapaciteti jo më pak se 18 ton)</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>
12	<i>Rrul gome – hekur (kapaciteti jo më pak se 12 ton)</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>
13	<i>Rrul hekur – hekur (kapaciteti jo m pak se 8 ton)</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
14	<i>Rrul asfalti me gome - gome (Kapaciteti jo më pak se 4 ton)</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
15	<i>Kompresor</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>
16	<i>Autobot uji me sprucator</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
17	<i>Frezë asfalti</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
18	<i>Autobetoniere</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>
19	<i>Fadromë me kove përpara dhe mbrapa</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>
20	<i>Pompë betoni</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>
21	<i>Pajisje për testimin e presionit</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
22	<i>Pompë presioni për testim hidraulik</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
23	<i>Instrument i kombinuar për PH, Ocugen, Temperaturën, Trazimin dhe mbetjet e klorit</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
24	<i>Pajisje e lëvizshme me ultratinguj për matjen e rrjedhjes/prurjes (Pajisja digitale)</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>
25	<i>Eskavator me goma</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>
26	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>
27	<i>Impiant automatik betoni të pajisur me QKL kodit II 1.A</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
28	<i>Eskavator me zinxhirë</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>
29	<i>Eskavator me zinxhirë me çekiç pneumatik</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
30	<i>Minifadromë</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
31	<i>Bobcat</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
32	<i>Dumper</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>
33	<i>Minieskavator</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>
34	<i>Set semaforesh</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>
35	<i>Gazogjen</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
36	<i>Nyje inertesh e pajisur me leje mjedisore III.1.B dhe IV.1 B 2</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
37	<i>Fabrikë asfalti pajisur me leje mjedisore III.1.B</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
38	<i>Zmerilatriçe</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
40	<i>Makineri për shkulje pemësh</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>

41	<i>Trancher me vakum me punime specifike</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
42	<i>Trancher për hapje kanali 20 ton</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
43	<i>Makinë teknologjike për pastrim puseta të ujësjellës kanalizime të zgarave të shiut vetëshkarkuese me kazan të mbyllur dhe transport materialesh mbetjesh të ndryshme</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
44	<i>Sondë për zhbllokim dhe pastrim të kanalizimeve, të shiut dhe tubacioneve të ndryshme</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
45	<i>Autobot për zhbllokim kanalizimesh pajisur me pompë presioni dhe pompë vakumi vetëshkarkuese e pajisur edhe me depozitë për transport të ujit të pastër dhe mbetjeve të tjera</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
46	<i>Batipal për ngjeshjen e kanaleve</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
47	<i>Sistem wellpoint</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>
48	<i>Aparat për ngjitjen e tubave kokë më kokë ndër të cilët njëri të jetë CNC</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>
49	<i>Makinë shpues horizontale për tejkalimin e rrugëve</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) certifikatë përtransport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b) Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c) Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.
- e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje si dhe në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme targa e mjetit.
- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në shtojcën 10 në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

- g) **Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklarohen se mjetet dhe pajisjet e deklaruara sipas shtojcës 10 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.**
- h) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qira me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor*

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- *Kokore minimumi 100 copë*
- *Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 15 copë*
- *Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 30 copë*
- *Rripa sigurimi minimumi 5 copë*
- *Prozhektor ndriçimi natën minimumi 5 copë*
- *Fikëse zjarri minimumi 5 copë*

Pajisjet e mësipërme të provohen me dorëzimin e faturave të blerjes, akt zhdoganimi ose kontratave të mara me qira të pajisjeve. (bashkëlidhur ankesës DST-të).

Pra, në këtë kriter kualifikues nuk është përcaktuar që të deklarohet se mjetet e kërkuara do të përdoren vetëm për këtë objekt prokurimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri secili prej anëtarëve të BOE dhe konkretisht “Liqeni VII” SHA dhe “Kupa” SHPK kanë plotësuar dhe dorëzuar secili shtojcën 10 “Mbi disponimin e makinerive” të DST, ku kanë deklaruar se këto mjete do të përdoren vetëm për realizimin të objektit të kësaj kontrate. (bashkëlidhur shtojcat 10 të kësaj procedure prokurimi të dorëzuara nga “Liqeni VII” SHA dhe “Kupa” SHPK).

Në kriterin kualifikues në pikën 11, të “Kritereve të veçanta të kualifikimit” të “Kapaciteti teknik” të shtojcës 16 të DST të procedurës së prokurimit të kontratës së lidhur midis BOE “Liqeni VII” SHA & “Kupa” SHPK dhe Bashkisë Kamëz, me objekt: “Loti 7: Rikonstruksionin e kopshtit “Ahmet Zogu”, është përcaktuar se:

- 11. Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:**

Nr	Lloji i Makinerive	Njesia	Sasia	Gjendja
	<i>Automjete vetëshkarkues kapaciteti mbajtës mbi 20 ton</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose</i>

	<i>15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion</i>			<i>me qera</i>
	<i>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Kokë tërheqëse</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Rimorkiator</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Autobetonierë</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Autopompë betoni me krah min 36m</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Automjet me kosh për punime në lartësi</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Autobotuji</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Betonierë kantieri</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Depozita uji 5000 litra</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Autvinç 7-10 ton</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Gjenerator jo më pak se 150 kw</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Dumper</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Minieskavator</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Minifadrome</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Semaforë</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Gazogjen</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Pirun ngrites</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>

	<i>Pompë gëlqere</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Zmerilatriçe</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Makineri për shkulje pemësh</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Pompë suvatimi</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Sharrë betoni</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Prerëse pllakash betoni</i>	<i>Copë</i>	<i>3</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Tub shkarkimi për mbeturina</i>	<i>Ml</i>	<i>80</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Vinç elektrik</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Saldatriçe</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Skeleri</i>	<i>M2</i>	<i>1000</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
	<i>Zyrë kantieri e lëvizshme</i>	<i>Copë</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>

- a) *Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*
- b) *Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet te jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).*
- c) *Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).*
- d) *Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.*

- e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje si dhe në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme targa e mjetit.
- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në shtojcën 10 në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara sipas shtojcës 10 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.
- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronësi ose me qira me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 100 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 15 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 30 copë
- Rripa sigurimi minimumi 5 copë
- Prozhektor ndriçimi natën minimumi 5 copë
- Fikësve zjarri minimumi 5 copë

Pajisjet e mësipërme të provohen me dorëzimin e faturave të blerjes, akt zhdoganimi ose kontratave të marra me qira të pajisjeve.

Pra në këtë kriter kualifikues nuk është përcaktuar që të deklarohet se mjetet e kërkuara do të përdoren vetëm për këtë objekt prokurimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri secili prej anëtarëve të BOE dhe konkretisht “Liqeni VII” SHA dhe “Kupa” SHPK kanë plotësuar dhe dorëzuar secili shtojcën 10 “Mbi disponimin e makinerive” të DST, ku kanë deklaruar se disponojnë mjetet e përshkruara në këtë shtojcë, por në asnjë rast nuk kanë deklaruar se këto mjete do të përdoren vetëm për realizimin e objektit të kësaj kontrate. (bashkëlidhur shtojcat 13 të kësaj procedure prokurimi të dorëzuara nga “Liqeni VII” SHA dhe “Kupa” SHPK).

Prandaj, për sa përshkruam më sipër, kjo arsye skualifikimi nuk qëndron, pasi në kriterin kualifikues të pikës 2.3.8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të “Kapaciteti teknik” të shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit të modifikuara nuk është përcaktuar jo vetëm që ofertuesit duhet të deklarojnë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8/C mjetet e përcaktuara në pikën 2.3.8 dhe dorëzimin e saj, por edhe me deklarim nga ana e ofertuesit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të faktit se këto mjete të deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe që ky deklarim lidhur me angazhimin do të jetë objekt verifikimi nga ana e KVO dhe në rast se konstatohej se këto mjete janë të angazhuara në kontrata të tjera atëherë oferta do të skualifikohet, pra kjo arsye skualifikimi është mbështetur mbi një kriter kualifikues të pakërkuara në dokumentet e tenderit të modifikuara. Gjithashtu, në

kriterere kualifikuese të dokumenteve të tenderit të kontratave që “Liqeni VII” SHA (si anëtar i BOE) ka me Bashkinë Kamëz nuk ka qenë kërkuar që të deklarojmë se mjetet e përmendura në këto dokumente dhe të deklaruar në shtojcat respektive “Mbi disponimin e mjeteve” nga ana e anëtarëve të BOE-ve do të jenë të angazhuara vetëm në kontratë respektive”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.8 tek kapaciteti teknik, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5 deri ne 12 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton)</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 10 ton)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 0.5 ton deri 5 ton për secilin kamionçinë)</i>	<i>5 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobitumatrice</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Ekskavator me goma</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Ekskavator me zinxhirë</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-hekur nën 6 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-gomë mbi 10 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-hekur deri 8 ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-gomë deri në 6,5 ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

<i>Kompaktor</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fadromë me goma</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Grejder me goma e targuar</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pirun</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Buldozer</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinç</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minieskavator</i>	<i>5 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Frezë me gjerësi 60 cm</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Frezë me gjerësi 90 cm</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fabrikë asfaltbetoni e pajisur me leje III.1.B</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera/Kontrate noteriale furnizimi</i>
<i>Dozator për prodhimin e asfaltbetonit me ngjyrë</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Nyje thyerje materiale inerte</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minifadromë</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator</i>	<i>5 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motosaldatrice</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Elektroorgano</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kulle ndriçimi</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makine për ngjitje tubash HDPE</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makineri prerëse asfalti</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vinç me kosh</i>	<i>2 Copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. (**Shtojca 8 /C**)

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.
- d) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Në shtojcën e modifikuar më datë 09.07.2021 “Mbi ndryshimin e kriterëve të veçanta”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Në shtojcën 1 të datës, 09.07.2021, pika 2.3.8

6. Në pjesën Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik pika 2.3.8

BËHET

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5 deri në 12 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton)	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 10 ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 0.5 ton deri 5 ton për secilin kamionçinë)	3 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	2 copë	Pronësi ose me qera

<i>Autobitumatriçe</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Ekskavator me goma</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Ekskavator me zinxhirë</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fadrome me goma</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-hekur deri 6 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-hekur deri 8 ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-gome deri në 6,5 ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul hekur-gome mbi 10 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompaktor</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Grejder me goma e targuar</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pirun</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Buldozer</i>	<i>1 copëe</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinç</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minieskavator</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Frezë me gjerësi 60 cm</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Frezë me gjerësi 90 cm</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fabrike asfaltobetonit e pajisur me leje III.1.B</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera/Kontrate noteriale furnizimi</i>
<i>Nyje thyerje materiale inerte</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minifadromë</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator</i>	<i>5 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

<i>Motosaldatriçe</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Elektroorgano</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kullë ndriçimi</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makine për ngjitje tubash HDPE</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makineri prerëse asfalti</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vinç me kosh</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

III.2.2. Në shtojcën 8/C, “*Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

C: DEKLARATË “Për disponimine mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se zoteroj mjetet pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën.

Mjetet e poshtëshënuara, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do anagazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

<i>Në pronësi</i>				
<i>Lloji i Mjetit</i>	<i>Targa</i>	<i>Nr. Lejes qarkullimit</i>	<i>Nr. Shasisë</i>	<i>Të tjera</i>

1				
2				
3				
4				
5				

<i>Me qira</i>					
<i>Lloji i Mjetit</i>	<i>Targa e mjetit</i>	<i>Nr. Lejes qarkullimit të mjetit</i>	<i>Nr. Shasisë së mjetit</i>	<i>Nr. Kont së qerasë (noterisë)</i>	<i>Afati i kontratës qerasë (data e fillimit dhe mbarimit)</i>
1					
2					
3					
4					
5					
6					

<i>Kontratë furnizimi</i>				
<i>Materiali/prod ukti për të cilin paraqitet kontrata e</i>	<i>Nr. Kont sëfurnizimi t (noterisë)</i>	<i>Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)</i>	<i>Të tjera</i>	

<i>furnizimit</i>				
1.				
2				
3				
4				

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj¹ nën përgjegjësinë time të vetme se:</i>	
<i>Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.</i>	
<i>Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, etj ., i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të</i>	

angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.	
--	--

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Firma _____

Vula _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të Informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

Shënim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Liqeni VII” SHA & “Al-Asfalt” SHPK & “SMO Union” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar:

- Shtojcën 8/C, “Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit” nga operatori ekonomik “Liqeni VII” SHA më datë 22.07.2021 si dhe “Deklaratë për mjetet dhe pajisjes teknike” ku *Të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.*
- Shtojcën 8/C, “Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit” nga operatori ekonomik “Al-Asfalt” SHPK më datë 22.07.2021 si dhe “Deklaratë për mjetet dhe pajisjes teknike” ku *Të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të*

cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

- Shtojcën 8/C, “Formular Përmbledhës i Vetëdeklarimit” nga operatori ekonomik “SMO Union” SHPK më datë 15.07.2021 si dhe më datë 22.07.2021 “Deklaratë për mjetet dhe pajisjes teknike” ku *Të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Liqeni VII” SHA & “A1-Asfalt” SHPK & “SMO Union” SHPK kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me datë 19.07.2021, për bashkimin ndërmjet këtyre shoqërive të mësipërme përmes përfaqësuesve ligjor të tyre, për bashkëpunim të përkohshëm të shoqërive me rastin e pjesëmarrjes për tenderin me Autoritet Kontraktor Bashkia Kamëz me Objekt “Ndërtim Rruga Demokracia Loti III, Bathore”, me fond limit: 147,987,273 (njëqind e dyzet e shtatë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) Lekë pa TVSh, i cili zhvillohet më datë 22.07.2021, ku sipas së cilës: Shoqëria “**Liqeni VII**” SHA merr përsipër të kryejë punimet e ndërtimit në masën **39 %**, konkretisht zërat që do të përshkruhen në mënyrë të detajuar në pasqyrën e ndarjes së punimeve hartuar për këtë qëllim midis shoqërive pjesëmarrëse dhe bashkëngjitur si pjesë e pandarë e kësaj marrëveshje. Shoqëria “**A.1-Asfalt**” SHPK merr përsipër të kryejë punimet e ndërtimit në masën **51 %**, konkretisht zërat që do të përshkruhen në mënyrë të detajuar në pasqyrën e ndarjes së punimeve hartuar për këtë qëllim midis shoqërive pjesëmarrëse dhe bashkëngjitur si pjesë e pandarë e kësaj marrëveshje. Shoqëria “**S.M.O. UNION**” SHPK merr përsipër të kryejë punimet e ndërtimit në masën **10 %**, konkretisht zërat që do të përshkruhen në mënyrë të detajuar në pasqyrën e ndarjes së punimeve hartuar për këtë qëllim midis shoqërive pjesëmarrëse dhe bashkëngjitur si pjesë e pandarë e kësaj marrëveshje.

III.2.4. Në pikën 2, të nenit 14 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës”.

Në nenin 23 “Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik”, gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Agjencia e Prokurimit Publik për përmbushjen e detyrave të saj kryen këto funksione: c) miraton me vendim dokumentet standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit sipas rregullave të prokurimit publik;*

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të LPP-së përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.5 Në nenin 26, pika 1 dhe gërma “i” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti”;

Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”.

Në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Gjithashtu, në fazën e vlerësimit, autoriteti kontraktor duhet të mbahet në konsideratë parashikimi i nenit 88, pika 3 e VKM, sipas së cilës secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Pra, kriteri për kualifikim mbi disponimin e mjeteve dhe pajisjeve duhet të

përbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, autoriteti kontraktor mbas publikimit me datë 29.06.2021 të dokumenteve standarde të tenderit, për shkak të monitorimit nga Agjencia e Prokurimit Publik, ka publikuar edhe një shtojcë me datë 09.07.2021, ku ndër të tjera ka modifikuar edhe kriterin në lidhje me pikën 2.3.8. për mjetet/pajisjet që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e kontratës.

Në rastin konkret, pavarësisht ndryshime që janë bërë për këtë pikë me anë të shtojcës në dokumentet e tenderit, për plotësimin e kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Liqeni VII” SHA & “Al-Asfalt” SHPK & “SMO Union” SHPK, ka dorëzuar secili “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” si dhe “Deklaratë për mjetet dhe pajisjes teknike” ku kanë deklaruar se: “Të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës”.

Referuar arsyes së skualifikimit, KPP ka një keqinterpretim në lidhje me vlerësimin e shtojcave të formularit përmbledhës së vetëdeklarimit për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerve të nevojshme për zhvillimin me sukses të kontratës. Për të pasur një panoramë më të qartë në lidhje me këto shtojca, Komisioni iu drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik, e cila referuar edhe nenit 23 të LPP, miraton me vendim dokumentet standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit sipas rregullave të prokurimit publik si dhe jep këshilla dhe asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik.

Në lidhje me plotësimin e Formularit Përmbledhës të vetëdeklarimit, me shkresën nr. 1518/7 prot., datë 06.10.2021 Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Agjencisë së Prokurimit Publik, me anë të së cilës ka kërkuar për sqarim lidhur me “Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit” sipas dokumenteve standarde të tenderit për punë publike, konkretisht shtojca nr. 8/C/D, sqarim nëse këto dy deklarata kanë të njëjtin qëllim, dhe cila prej tyre prevalon në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Me shkresën nr. 6256/1 prot., datë 19.10.2021 protokolluar me tonën me nr. 1518/8 prot., datë 21.10.2021, nga Agjencia e Prokurimit Publik ka dërguar shkresën me lëndë “Kthim-përgjigje” ku ndër të tjera ka sqaruar se “Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim APP”) mori në shqyrtim shkresën tuaj Nr. 1518/7 prot., datë 06.10.2021 me objekt: “Kërkesë për sqarim”. Nga shqyrtimi i shkresës tuaj kuptojmë se, kërkon nga APP sqarim, sa i takon disa parashikimeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e Dokumenteve Standarde të Tenderit (në vijim “DST”) për Punë Publike.

Konkretisht, sipas jush, në shtojcën nr. 8 të DST, Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, citohet që, mjetet e poshtëshënuara, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

Ndërkohë që, në pikën D, të po kësaj shtojce: Deklaratë “Mbi Mosanagazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata të Tjera” citohet që, mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

Sa më sipër, kërkoni nga APP sqarim nëse këto dy deklarata kanë të njëjtin qëllim, dhe cila prej tyre prevalon në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Lidhur me sa keni kërkuar në shkresën tuaj se, APP i ushtron kompetencat e saj sipas parashikimeve të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” (në vijim LPP).

Në nenin 23, gërma “ç” të LPP përcaktohet se “Agjencia e Prokurimit Publik për përmbushjen e detyrave të saj jep këshilla dhe asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik”.

Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, nga autoriteti kontraktor ka si synim kryesor që, t’i shërbejë për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojmë se zotërojmë kualifikimet e nevojshme juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale, për të zbatuar kontratën, sipas parashikimeve të nenit 77 të LPP.

Në nenin 39/6/d, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (në vijim VKM), parashikohet që: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

.... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Gjithashtu, në nenin 26, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 2, gërma “i”, të VKM parashikohet se: “.. operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti”.

Pra, kriteri për kualifikim, mbi disponimin e mjeteve dhe pajisjeve duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas Shtojcës 8 të DST.

Qëllimi i paraqitjes së Deklaratës “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” në këtë shtojcë, është listimi, i mjeteve që disponon operatori ekonomik (në pronësi ose me qira) me të gjitha të dhënat e tyre, sikurse janë: lloji i mjetit, targa, shasia, etj.

Ndërkohë që, qëllimi i paraqitjes së Deklaratës “Mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata të Tjera”, po në këtë shtojcë, është garantimi i disponueshmërisë së mjeteve për plotësimin me sukses të kontratës, objekt prokurimi, sipas kërkesave mbi mjetet e kërkuara.

Pra, qëllimi për të cilat kërkohet paraqitja e secilës nga këto deklarata në shtojcën 8 të DST, është i ndryshëm. Në këtë kuptim, duke qenë se, nuk kanë të njëjtin qëllim, atëherë nuk mund të prevalojë asnjëra prej tyre, por secila duhet të interpretohet, sipas qëllimit të saj. Në këtë kuptim, nëse po vlerësohet garantimi i disponueshmërisë së mjeteve, ky vlerësim duhet bërë, duke iu referuar deklaratës “Mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Të Tjera”. Gjithsesi, marrë shkas nga konstatimi juaj, APP do të mbajë në konsideratë rastin në fjalë për saktësime të nevojshme që mund t’i bëhen kësaj shtojcë të DST”.

Për sa më lartë, Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor ka skualifikuar me pa të drejtë bashkimin e operatorëve ekonomikë, me arsyetim se, Në deklaratën përmbledhëse operatori ekonomik “LIQENI VII” SHA deklaroi se makineritë që ka deklaruar në këtë procedurë nuk i ka të angazhuara në asnjë procedurë tjetër, dhe se vërtetimi i të kundërtës përbën shkak për skualifikim, i cili nuk qëndron. Kjo, duke marrë shkak se kriteri në lidhje me mjetet në pikën 2.3.8 të shtojcës së kësaj procedure prokurimi objekt ankimi, ka ndryshuar dhe nuk është kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të deklarojnë se “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi”. Përtej kësaj, autoriteti kontraktor është shprehur në kriterin e pikës 2.3.8/d sipas dokumenteve të tenderit të publikuara më datë 29.06.2021, para publikimit të shtojcës me 09.07.2021, që deklarata në lidhje me mjetet për angazhimin e tyre është në kohën e ardhme dhe jo në kohën e tashme apo në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Për më tepër, në zhvillimin e korrespondencës me Agjencinë e Prokurimit Publik, e cila ka sqaruar se nëse po vlerësohet garantimi i disponueshmërisë së mjeteve, ky vlerësim duhet bërë, duke iu referuar deklaratës “Mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Të Tjera”, e cila shprehimisht cilëson se Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti, duke iu referuar kohës së ardhme dhe jo momentin aktual procedural kur po zhvillohet dhe po vlerësohet procedura e prokurimit.

Referuar përmbajtjes së Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit dhe shkresës me lëndë “Kthim përgjigje” nga Agjencia e Prokurimit Publik, Komisioni konstaton se, Deklarata “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt

kontrate” në këtë shtojcë, **është listimi, i mjeteve që disponon** operatori ekonomik (në pronësi ose me qira) me të gjitha të dhënat e tyre, sikurse janë: lloji i mjetit, targa, shasia, etj. Ndërkohë që, qëllimi i paraqitjes së Deklaratës “Mbi Mosanagazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata të Tjera”, po në këtë shtojcë, **është garantimi i disponueshmërisë së mjeteve për plotësimin me sukses të kontratës**, objekt prokurimi, sipas kërkesave mbi mjetet e kërkuara.

Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural ku ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt ankimi, për vlerësimin e garantimit të disponueshmërisë së mjeteve, duhet t’i referohet Deklaratës “Mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata të Tjera”, për plotësimin me sukses të kontratës, objekt prokurimi, sipas kërkesave mbi mjetet e kërkuara. Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Liqeni VII” SHA, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Klajger Konstruksion” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

“[...]Së fundmi dhe ndoshta është më e rëndësishmja është përdorimi i një standardi të dyfishtë në gjykimin e pjesëmarrësve në tender. BOE “Liqeni VII” SHA & “Al-Asfalt” SHPK & “SMO Union” SHPK ka hetuar për këtë skualifikim të pa drejtë dhe përdorimin e standardit të dyfishtë e argumenton si vijon: Dy nga operatorët pjesëmarrës në bashkimin e operatorëve BOE “Klajger Konstruksion” SHPK & “Varaku-E” SHPK & “Rafaelo 2002” SHPK, përkatësisht operatorët “Klajger kontruksion” SHPK dhe “Rafaelo 2002” SHPK janë të shpallur fitues dhe kanë në proces objekte.

Natyrisht lindin pyetje: Si ka mundësi që “Rafaelo 2002” SHPK nuk qenka i angazhuar për 3 objektet e shkruara më sipër? Asnjë makineri nuk është e angazhuar? Asnjë pjesëtar i stafit nuk është i angazhuar? Presupozojmë që jo, pra “Rafaelo 2002” SHPK nuk është i angazhuar te asnjë nga këto 3 kontrata! Po “Klajger Konstruksion” SHPK? Nuk është i angazhuar në asnjë

nga ato 10 kontrata të listuara më sipër? Asnjë pjesëtar i stafit? Asnjë makineri? Nga informacioni që ne kemi, shoqëria “Klajger Konstruksion” SHPK dhe “Rafaelo 2002” SHPK dhe “Arb-trans” SHPK nuk janë shoqëri që plotësojnë të gjithë dokumentacionin e tenderit për “infrastrukturë rrugore” dhe për rrjedhojë kanë përdorur gjithandej mjetet e “Varaku-E” SHPK. Nisur nga ky informacion që ne kemi, kërkojmë gjithashtu të hetoni angazhimin e mjeteve të shoqërisë “Varaku-E” SHPK. Ju lutemi të kryeni verifikimet për të gjitha kontrata e listuara më sipër dhe të dilni në një përfundim nëse Bashkia Kamëz ka mbajtur një standard kur ka skualifikuar shoqërinë “liqeni VI” SHA dhe pjesëtarët e tjerë të bashkimit apo ka përdorur një standard të dyfishtë duke listuar makineritë dhe stafin e Liqeni VII që sipas tyre janë të angazhuar dhe duke injoruar totalisht angazhimin e Klajger konstruksion dhe Rafaelo 2002. Presupozojmë që Bashkia Kamëz ka të drejtë rreth konceptit të angazhimit të stafit dhe makinerive dhe do të përdoret i njëjti standard për të gjithë. Atëherë si shoqëria Liqeni VII SHA (së bashku më bashkimin e operatorëve) ashtu edhe Klajger konstruksion (së bashku me bashkimin e operatorëve) duhet të skualifikohen dhe të kualifikohet një operator i cili është i pa angazhuar në asnjë objekt (sipas konceptit të angazhimit të Bashkisë Kamëz). Nëse nuk do të përdoret ky standard, dhe për arsyet e cilësuar më sipër bashkimi jonë i operatorëve nuk do të konsiderohet i angazhuar (sepse nuk është) atëherë BOE “Liqeni VII” SHA & “Al-Asfalt” SHPK & “SMO Union” SHPK duhet të kualifikohet dhe të shpallet si oferta fituese sepse është oferta më e ulët dhe plotëson të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet standard të tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Liqeni VII” SHA mbi kualifikimin e “Klajger Konstruksion” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit për të cilët paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Liqeni VII” SHA, mbi ofertën e shoqërisë “Klajger Konstruksion” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Liqeni VII” SHA & “Al-Asfalt” SHPK & “S.M.O. Union” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-99369-06-28-2021, me objekt: “*Ndërtim Rruga Demokracia Loti III, Bathore*”, me fond limit 147,987,273 (njëqind e dyzet e shtatë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Liqeni VII” SHA & “Al-Asfalt” SHPK & “S.M.O. Union” SHPK, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Liqeni VII*” SHA.

Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Anëtar

Anëtar

Fiorent Zguro

Anila Malaj

Kreshnik Ternova

Kryetar

Jonaid Myzyri